



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradecc@gmail.com

Nr.236prot.

Pogradecc, më 20.10.2016

RAPORT FINAL

**MBI AUDITIMIN E PROCEDURAVE TË SHËRBIMIT NË NDËRMARRJEN E
ADMINISTRIMIT TË HAPËSIRAVE TË GJELBRA NË BASHKINË POGRADEC PËR
PERIUdhËN QERSHOR 2015 DERI QERSHOR 2016**

Drejtuar: Ndërmarrjes së administrimit të hapësirave të gjelbra

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin në sektorin publik", Manuali I auditimit të brendshëm miratuar me urdhrin nr.69 dt.29.09.2010 të Ministrisë të Financave, Plani vjetor I Auditimit 2016, Ligji nr.139/2015 date 17/12/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", në planin e punës të miratuar nga titullari për vitin 2016 dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.12 dt.5.6.2012 "Mbi procedurat e kryerjes së auditimit të brendshëm në sektorin publik", grupi I punës nga Njësia e Auditimit të brendshëm në Bashkinë Pogradecc realizoi një angazhimi auditimi në Ndërmarrjen e administrimit të hapësirave të gjelbra për periudhën 01.06.2015 – 30.06.2016, dhe për këtë në përfundim të afatit të përcaktuar në projekt-raport për kundërshtime, përgatiti këtë raport final.

Struktura(viti 2016) dhe kategorizimi I pozicioneve të punës I administratës së ndërmarrjes së gjelbërimit është e firmosur nga kryetari I Bashkisë. Rregullorja e kësaj ndërmarrje është përpiluar por duhet të plotsohet dhe përpunohet me strukturën si dhe të firmoset nga drejtori dhe të vuloset me vulën përkatëse të ndërmarrjes për të marrë vlerë juridike.

Vendimi I Gjykatës për regjistrimin e kësaj ndërmarrje nuk na u vu në dispozicion me pretendimin se nuk është në dosjet e kësaj ndërmarrjeje.

Regjistri I asetëve nuk është I firmosur dhe vulosur me vulën përkatëse të ndërmarrjes apo bashkisë, përmban emërtimin (në krye të fletës) Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nuk përmban të dhënat(të paktën sipërfaqen) për pasuritë e paluajtshme që administrojnë dhe mirëmban kjo ndërmarrje.

Regjistri I realizimit të prokurimeve publike të blerjeve të vogla (8 procedura) për 2015 është I pa firmosur nga P/D/Ekonomike dhe Drejtori dhe I pa vulosur me vulën përkatëse të ndërmarrjes. Regjistri I parashikimeve për këto prokurime, kopje e regjistrimit shtesë të parashikimeve publike për 2015 nr.11prot. dt.23.11.2015 është me objekt "Blerje veshje për punonjësit me fond limit 120.000 është korigjuar lloji I procedurës dhe në dt.09.12.2015 në degën e thesarit Pogradecc është dërguar regjistri I ndryshuar I parashikimeve .

Gjatë verifikimit të dokumentacionit të prokurimit publik për vitin 2015 u vu re se janë zhvilluar 9 procedura Blerje e vogël me objekt prokurimi përkatësisht:

1.Blerje vaj, filtër, antifrizë dhe shërbim pune për Ndërmarrjen e Gjelbërimit (urdhëri I prokurimit ka vlerën limit 100.000lek ndërkohë që është llogaritur dhe miratuar fondi limit prej 7000lek).

2. Blerje lëshues, zgjatues e zezë, prize, spinë e tokëzuar, spinë treshe, ngjitës për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (fondit limit prej 4000lek).

3. Blerje benzinë për Ndërmarrjen e Gjellbërimit

Kërkesa për blerjen e materialeve mungon. Proces-verbal per testim tregu datë 11.05.2015 nga komisioni I blerjeve të vogla nga pyetja e tre operatoreve ekonomike pa u shoqëruar me oferta përkatëse zyrtare të secilës). Urdhëri I prokurimit nr.10 datë 02.07.2015 I titullarit te Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e Gjellbërimit ka fondin limit me vlerë 230.100lek ndërsa sasinë prej 250litra benzinë ndërkohë që preventive dhe Proces-verbal datë 30.04.2015 nga komisioni I blerjeve te vogla per miratimin e fondit limit flasin për 1306litra. Kopje e Ftesës për ofertë ku data e zhvillimit të prokurimit është 15.05.2015 ndërkohë që urdhri I prokurimit ka dalë në dt.02.07.2015. (pra ftesa për ofertë dhe procedura e prokurimit është bërë 1muaj e gjysëm para daljës së urdhrit të prokurimit nga titullari). Gjithashu I mungojnë disa rubrika sipas formularit standart nr.3. duke mos përcaktuar dokumentacionin që duhet të sjellë op. ek. fitues. Në bazë të nenit 40 (pika 5) të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik”. Për këtë nuk ka dokumentacion përkatës. Gjithashtu sasi e përcaktuar ne këtë ftesë është 1230litra gjithsej ndërkohë që në preventivin e llogaritjes së fondit limit sasia është 1306 litra.

Kontrata midis Ndërmarrjen e Gjellbërimit dhe A.K.F.Petroleum është e pa plotë dhe jo sipas dokumentave standarte të tenderit. Likujdimi I parë është bërë në maj 2015 pa dalë urdhri I prokurimit nga titullari. Mungon Njoftimi I fituesit, njoftimet e operatoreve ek. të skualifikuar Në lidhje me këtë tender janë nxjerrë urdhëra të tjerë prokurimi duke ndarë sasinë e benzines, konkretisht sa më poshtë. Për prokurimin e zhvilluar në 15.05.2015 kanë dalë edhe 3 urdhra prokurimi të tjerë për sasi të ndryshme .

Këto veprime janë të pabazuar në legjislacionin përkatësisht VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 Për Proedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël.

4. Blerje material gjellbërimi dhe vegla për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (fondi limit prej 20 290lekë).

5. Blerje material gjellbërimi dhe vegla për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (me vlerën limit 36 450 lek).

6. Blerje material kancelarie për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (ka vlerën limit 13 000 lek).

7. Blerje bojë printeri për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (ka vlerën limit 50 000 lek).

8. Blerje veshje/jeleke për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (ka vlerën limit 30 000 lek).

9. Blerje material gjellbërimi për Ndërmarrjen e Gjellbërimit (ka vlerën limit 20 000 lek.).

Në përgjithësi në këto procedura prokurimi u vu re se:

Kërkesa për blerjen e materialeve dhe preventivi i llogaritjes së vlerës limit **mungojnë**.

Proces-verbalet për testimin tregu nga komisioni I blerjeve të vogla janë të pa plotë pasi nga pyetja e tre operatoreve ekonomike nuk është shënuar vlera e ofertës të secilit, çmimet për secilin mall dhe çmimi mesatar. Proces-verbal datë 20.08.2015 nga komisioni I blerjeve të vogla për miratimin e fondit limit janë të pa plotë nuk ka objektin e prokurimit etj. Urdhërat e prokurimit kanë vlerën limit 100.000lek ndërkohë që llogaritet dhe miratohet fondi limit tjetër

këto urdhra nuk janë shoqëruar me ftesën për ofertë në bazë të nenit 40 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”). (Ka dy urdhra prokurimi me nr.8 në vitin 2015). Procesverbalet tip të prokurimeve me vlerë nën 100.000 leke(sipas formularit nr.5 te udhezimit nr.3 date 27.01.2015 te APP “Per proceduren e prokurimit me vlerë të vogël), për 3 operatorët ek. nuk janë plotësuar sasia dhe çmimi, preventiv përkatës).

Për vitin 2016: Me shkresë nr.217prot. dt.16.02.2016 është dërguar në degën e thesarit regjistri I parashikimeve publike për **2016**(duhej dërguar edhe në Agjencinë e Prokurimit Publik Tiranë).

1.Blerje drurë decorative(fidanë rrap) për Ndërmarrjen e Gjellbërimit.(2016)

Kërkesa për blerjen e materialeve dhe preventivi i llogaritjes së vlerës limit mungojnë.

Urdhëri I prokurimit nr.1 datë 4.3.2016 I titullarit te Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e

Gjellbërimit ka vlerën limit 73 500 lek, nuk është shoqëruar me ftesën për ofertë në bazë të nenit 40 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

2.Blerje farë bari për Ndërmarrjen e Gjellbërimit.

Kërkesa për blerjen e materialeve dhe preventivi i llogaritjes së vlerës limit mungojnë.

Proçes-verbal për testim tregu datë 21.03.2016 nga komisioni I blerjeve të vogla nga pyetja e tre operatoreve ekonomike shoqëruar dhe me ofertat përkatëse. Çmimi mesatar prej 93 500lek(duhet shënuar vlere e fondit limit) .(Ky p-v është bërë pas daljes së urdhrat të prokurimit).

Proçes-verbal datë 16.03.2016 nga komisioni I blerjeve të vogla për miratimin e fondit limit prej 93500.

Urdhëri I prokurimit nr.2 datë 16.3.2016 I titullarit te Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e Gjellbërimit ka vlerën limit 93 500 lek, nuk është shoqëruar me ftesën për ofertë në bazë të nenit

40 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).(Ky urdhër ka dalë pa u testuar tregu për përcaktimin e fondit limit.)

Në prill të 2016 janë zhvilluar :

1. Prokurimi me vlerë të vogël prej 17.500lek me objekt: Blerje nitrat dhe pesticide(e paparashikuar ne regjistër).
2. Prokurimi me vlerë të vogël prej 18.250lek me objekt: Blerje material gjellbërimi. Ky prokurim së bashku me prokurimin zhvilluar në mars 2016 me vlerë 93 500lek kanë tejkualuar vlerën e parashikuar në regjistrin e prokurimeve publike të Ndërmarrjes së gjellbërimit.
3. Prokurimi me vlerë të vogël prej 12.400lek me objekt: Blerje material zyre(e paparashikuar ne regjistër).
4. Prokurimi me vlerë të vogël prej 48.700lek me objekt: Blerje nitrat dhe pesticide.(zhvilluar procedura e prokurimit në prill të 2012)

Në maj të 2016 janë zhvilluar :

1. Prokurimi me vlerë të vogël prej 15.460lek me objekt: Blerje vaj makine korrëse.
2. Prokurimi me vlerë të vogël prej 10.000lek me objekt: Blerje nitrat (e paparashikuar ne regjistër).
3. Prokurimi me vlerë të vogël prej 22.250lek me objekt: Blerje material gjellbërimi. Ky prokurim së bashku me prokurimet zhvilluar në mars 2016 me vlerë 93 500lek dhe në prill me vlerë 18 250lek kanë tejkualuar vlerën e parashikuar në regjistrin e prokurimeve publike të Ndërmarrjes së gjellbërimit.
4. Prokurimi me vlerë të vogël prej 16.740lek me objekt: Blerje material për shatrvanet.

Në qershor të 2016 janë zhvilluar :

1. Prokurimi me vlerë të vogël prej 45.500lek me objekt: Blerje nitrat dhe pesticide. (e paparashikuar ne regjistër).
2. Prokurimi me vlerë të vogël prej 50.000lek me objekt: Blerje nitrat dhe fare.(zhvilluar procedura e prokurimit në prill të 2012)
3. Prokurimi me vlerë të vogël prej 8.300lek me objekt: Blerje materiale gjelbërimi. Ky prokurim së bashku me prokurimet zhvilluar në mars 2016 me vlerë 93 500lek dhe në prill me vlerë 18 250lek, në maj me vlerë 22 500lek, kanë tejkaluar vlerën e parashikuar në regjistrin e prokurimeve publike të Ndërmarrjes së gjelbërimit.

—**Auditimi I veprimeve me bankë dhe magazinë**

Ditari I periudhës qershor – dhjetor 2015 dhe ai janar-qershor 2016 kishte mospërputhje midis datave të faturave dhe datave të hedhjes së kësaj fature në ditar.Nga auditimi I dokumentave të bankës rezultoi se Urdhër shpenzimet ishin të shoqëruara me të gjithë dokumentacionin përkatës,si me procesvebalin e marrjes në dorzim të mallrave,fletë daljen e furnitorit si dhe me fletë hyrjen e magazines të firmosura këto rregullisht nga personat përkatës që ngarkon ligji dhe urdhrat përkatës.Nga ana e finances të gjitha këto veprime janë pasqyruar në ditarin e bankës.Nga auditimi I ditarit të bankës rezultoi që të mos ketë ditar banke për vlerat e arkëtuara nga celjet si dhe nga veprimet e ndryshme. Nga auditimi I ushtruar në dokumentat e magazines hyrje dhe dalje rezultoi që nga ana e ndërmarrjes të ishin bërë hyrje të gjitha furnizimet e kryera por në disa raste u vu re se vec mallrave dhe materialeve ishte bërë hyrje edhe puna gjë që bie në kundërshtim me ligjin pasi puna është shërbim.Për këtë përmëdim FH Nr 2 dt 24.02.2015 për vlerën 15.250 lekë,FH Nr7 dt.18.5.2015për vleftën 16000 lekë,FH Nr 10 dt 05.06.2015 për vlerën 1600 lekë.Fletë hyrjet ishin të rregullta si nga ana formale ashtu dhe nga ana ligjore mbasi ishin përpiluar dhe plotësuar konform ligjit.Të gjitha fletë hyrjet ishin hedhur në ditarin e magazinës dhe ishin kontabilizuar në llogaritë përkatëse.Nga auditimi I fletë daljeve rezultoi që për të gjitha vlerat material të dala nga magazine ishin prerë fletë dalje nga ana e magazinieres të cilat ishin firmosur si nga ana e magazinieres ashtu edhe nga personi marrës në dorzim.Për daljen e vlerave materiale nga magazinë përdorej urdhër dorzimi I firmosur si nga lëshuesi ashtu edhe nga marrsi në dorzim.Veç urdhrat të dorzimit fletë dalja shoqërohej edhe me preventive dhe situacione ,por këto preventiva dhe situacione nuk ishin të saktë pasi nuk specifikonin volume e punës që do të kryhej,dhe volumin e punës të kryer në fakt,si dhe materialet sipas normativës që duheshin për këto volume punimesh.Për karburantin e përdorur për automjetin ishte mbushur një fletë udhëtimi por ishte e pa firmosur nga urdhëruesi,dhe nuk kishte llogaritje të konsumit të karburantit sipas normativave.Për vitin 2016 preventivat dhe situacionet ishin hartuar mirë mbasi kishin pasqyruar harxhimet në bazë të volumeve të punës që do të kryhej. Administrimi I vlerave materiale të ndërmarrjes .Nga ana e ndërmarrjes janë pasqyruar asetet e saj në bilancin kontabël por nuk kemi inventarin e tyre nga se përbëhen dhe si rezultat nuk dimë se çfarë vlere ka sejcili.Në zbatim të kërkesës për evidentimin e aseteve nga ana e ndërmarrjes u hartua lista e aseteve por janë pa vlera.Inventarizimi I tyre është bërë I pjesshëm gjë që bie në kundërshtim me ligjin nr 10296 dt 08/07/2010 si dhe udhëzimin e ministries së financave nr 30 dt 27.12.2011. Nga verifikimi I pasqyrimit të debi kredive në bilanc rezulton që të jenë pasqyruar drejt dhe në pozicionet përkatse duke I paraqitur edhe në pasqyra me përbërjen analitike.

Në Ndërmarrjen e administrimit të hapësirave të gjelbra u dërgua projekt-raporti nr.213prot..dt07.10.2016 për të cilin nuk u paraqitën kundërshtime brenda 10 ditëve pune nga dorëzimi I projekt-raportit.

Përfundimisht, Njësia e auditimit të Brendshëm del në konkluzionin se përgjithësisht Ndërmarrja e administrimit të hapësirave të gjelbra ka realizuar një veprimtari në përputhje me legjisllacionin përkatës megjithatë për përmirësimin e punës në të ardhmen mbështetur në kërkesat e ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të

Brendhshëm dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me auditimin e brendshëm të miratuar nga Ministri I Financave. **REKOMANDOJMË:**

1. Të pregatitet regjistri I asetëve në të cilin të evidentohen të gjitha të dhënat në lidhje me pasuritë në administrim të Ndërmarrjes së hapsirave të gjelbëra. Gjithashtu ky regjistër të jetë I firmosur dhe vulosur me vulën përkatëse.
2. Të bëhet inventarizimi I asetëve dhe vlerave të tjera material.
3. Proçedurat e Prokurimeve të mos tejkalojnë vlerën e parashikuar në regjistrin e prokurimeve publike të Ndërmarrjes së gjelbërimit.
4. Të shoqerohen me ftesën për ofertë urdhërat e prokurimit (në të ardhmen), *në bazë të nenit 40 të VKM nr.914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*).
5. Operatorëve ekonomikë tu kërkohet që të paraqesin ofertat e tyre të shoqëruara me lista e hollesishme e çmimeve (preventivi) në zbatim të nenit 17 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
6. Të zbatohen proçedurat ligjore të prokurimit publik VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël, për hartimin e të gjithë dokumentacionit përkatës të prokurimeve.
7. Të bëhet llogaritja e fondit limit duke qënë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve përkatëse.
8. Të hapet menjëherë ditari I bankës për të ardhurat.
9. Të evidentohen të gjitha asete që janë jashtë përdorimit dhe të merren masat për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre.

Në zbatim të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, subjekti Ndërmarrja e administrimit të hapësirave të gjelbra, të marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve sipas kësaj shkrese. Subjekti që është audituar të njoftojë me shkrim NJAB-në për realizimin e rekomandimeve herë pas here sipas afateve të përcaktuara.

NJËSIA E AUDITIMIT

Llazi Deti

Juriste: Kleda Vako

Për Ndërmarrjen e administrimit të hapësirave të gjelbra